



SAMITI II-të DIASPORËS



28 SHKURT – 2 MARS



SAMITI II DIASPORËS

PËRMBAJTJA

- I. HYRJE
- II. AKTET
- III. FTESA ELEKTRONIKE
- IV. LETRA E KRYEMINISTRIT
- V. PROGRAMI I SAMITIT
- VI. REZOLUTA E KUVENDIT
- VII. SHPERNDARJA E FTESAVE ZYRTARE VIII.
REGJISTRIMI "ON-LINE" PER PJESMARRJE NE SAMIT



SAMITI II DIASPORËS

I. HYRJE

Samiti i II-të i Diasporës Shqiptare do të zhvillohet në datat 28 shkurt - 2 mars dhe do mikpresë personalitete shqiptare të spikatura të biznesit, shkencës, artit dhe kulturës që jetojnë jashtë vendit. Ky Samit do të mundësojë një hapësirë diskutimi për çështje të ndryshme të politikëbërjes së shtetit shqiptar, përfshirë qasjen e re të bashkëpunimit me Diasporën dhe njëkohësisht këndvështrimin e Diasporës mbi impaktin e këtyre politikave, duke evidentuar sukseset e arritura dhe vështirësitë e hasura gjatë këtij bashkëpunimi.

Gjatë Samitit pjesëmarrësit do të kenë mundësinë të paraqesin projekte dhe propozime konkrete për krijimin dhe fuqizimin e lidhjeve mes Shqipërisë dhe vendeve pritëse, si edhe shkëmbimin e eksperiencave, me qëllim rritjen e kontributit të Diasporës në zhvillimin ekonomik, shoqëror e kulturor të vendit. Samiti synon gjithashtu fuqizimin e ndjenjës së identitetit dhe vlerave kombëtare të shqiptarëve, përmirësimin e imazhit dhe rritjen e rolit të Shqipërisë në zhvillimet rajonale e globale.



SAMITI II DIASPORËS

II. AKTET LIGJORE

2.1 Programimi i mbajtjes së Samitit të II-të Diasporës është përcaktuar nga Komisioni Shtetëror për organizimin e veprimtarive në kuadër të “Vitet mbarëkombëtar të Gjergj Kastriotit-Skënderbeut” me Vendimin Nr. 1, datë 12.01.2018.



SAMITI II DIASPORËS

REPUBLIKA E SHQIPËRISË KRYEMINISTRIA

Komisioni Shtetëror për organizimin e veprimtarive, në kuadër të “Vitet mbarëkombëtar të Gjergj Kastriot Skënderbeut”.

**VENDIM
Nr. 1, datë 12.01. 2018**

PËR MIRATIMIN E EVENTEVE DHE PROJEKTEVE NË KUADËR TË “VITIT MBARËKOMBËTAR TË GJERGJ KASTRIOTIT-SKËNDERBEUT”

Në mbështetje të pikës 4 të vendimit nr. 494, datë 13.9.2017 të Këshillit të Ministrave për krijimin e Komisionit Shtetëror për organizimin e veprimtarive, në kuadër të “Vitet Mbarëkombëtar të Gjergj Kastriotit-Skënderbeut”, Komisioni Shtetëror për organizimin e veprimtarive, në kuadër të “Vitet Mbarëkombëtar të Gjergj Kastriotit-Skënderbeut”,

VENDOSI:

I. Miratimin e projekteve sipas planit të veprimit dhe kalendarit të festimeve në zbatim të Vitit Mbarëkombëtar të Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, si më poshtë vijon:

Kryeministri, Drejtorja e Shërbimeve Qeveritare:

Eventi “Tre Ditët e Yllit të Mëngjesit”, kushtuar 550 vjetorit të vdekjes së Gjergj Kastriotit Skënderbeut, nën shenjën e komunitetit Arbëresh.

Ministria e Kulturës:

- a) Shpallja e një konkursi mbarëkombëtar dhe ndërkombëtar për krijimtarinë e re muzikore me tematikë të dedikuar;
- b) Konkurs publik “Artificial Intelligence” për paraqitjen e platformës më të mirë inovative;
- c) Konkurs Mbarëkombëtar i Dramaturgjisë së re mbi Skënderbeun;
- d) “Koncert i Ansambllit Popullor në Diasporë” të grupeve, shoqatave artistike në Diasporë;
- e) Krijimin e një linku specifik në website-n e Bibliotekës Kombëtare kushtuar literaturës shkencore, por edhe të përgjithshme për Skënderbeun;
- f) Restaurimi i Kalasë së Shkodrës;



SAMITI II DIASPORËS

- g) Restaurimi i vendvarrimit të Skënderbeut;
- h) Projekt restaurimi dhe muzealizimi, vendlindja e Kastriotëve, Sine, Dibër;
- i) Restaurimi i shtëpisë së vëllezërve Frashëri;
- j) Ekspozita Marubi në Milano;
- k) 60 vjetori i Shqipërisë në UNESCO - Aktiviteti dhe prezantimi.

Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave:

- a) Përmirësimi i Labororit Qendror të Restaurimit në DPA;
- b) Digjitalizimi i shërbimit në sallën e studimit;
- c) Mësojmë përmes arkivave;
- d) Digjitalizimi i fototekës së Arkivit Qendror Shtetëror.

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë:

Lançimi i një burse ekselence “Robert Elsie” për arkivistë paleografë dhe specialistë të gjuhëve antike

Ministria e Mbrojtjes:

- a. Kompletim me uniforme të re për orkestrën frymore të forcave të armatosura (OFFA);
- b. Kompletim me instrumente muzikorë për orkestrën frymore të forcave të armatosura (OFFA). Kryeministria, Ministria e Kulturës, Ministria e Arsimit, Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare: Organizimin dhe bashkërendimin e Konferencës Albanologjike kushtuar gurës së Skënderbeut.

Kryeministria, Ministria e Kulturës, Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare:

- a. Veprimtari kulturore, shkencore dhe atdhetare në kuadër të përkujtimit të 140-vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit;
- b. Veprimtari kulturore, shkencore dhe atdhetare në kuadër të përkujtimit të 110-vjetorit të Kongresit të Manastirit dhe figurave të tyre kryesore.



SAMITI II DIASPORËS

Kryeministria, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministri i Shtetit për Diasporën, Drejtorja e Shërbimeve Qeveritare:

- I. Organizimin e Samitit të II-të të Diasporës shqiptare.
- II. Komisioni Shtetëror i propozon këto veprimtari dhe realizime për financim të Këshillit të Ministrave.
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KOMISIONIT SHTETËROR

EDI RAMA



SAMITI II DIASPORËS

2.2 *Procesi konsultativ i vendimarrjes për Samitin e II-të të Diasporës kalon nga Komiteti Shtetëror i Diasporës, i cili funksionon sipas akteve nënligjore të mëposhtme:*

- **VENDIM Nr.690, PËR KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOMITETIT SHETËROR PËR DIASPORËN, datë 22.11.2017**
- **URDHËR Nr. 231, PËR PËRBËRJEN DHE DETYRAT E SEKRETARIATIT TEKNIK TË KOMITETIT SHETËROR PËR DIASPORËN, datë 07.12.2017**



SAMITI II DIASPORËS

REPUBLIKA E SHQIPËRISË KËSHILLI I MINISTRAVE

VENDIM

Nr.690, datë 22. 11. 2017

“PËR KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOMITETIT SHTETËROR PËR DIASPORËN”

Në mbështetje të neneve 95, pika 2, dhe 100, të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngritjen e Komitetit Shtetëror për Diasporën, këtu e në vijim Komiteti, si organ konsultativ i Këshillit të Ministrave për bashkërendimin e politikave e të veprimtarive shtetërore në fushën e Diasporës.
2. Komiteti kryesohet nga Kryeministri dhe ka në përbërje të tij këta anëtarë:
 - a) Ministrin për Evropën dhe Punët e Jashtme;
 - b) Ministrin e Brendshëm;
 - c) Ministrin e Financave dhe Ekonomisë;
 - ç) Ministrin e Drejtësisë;
 - d) Ministrin e Arsimit, Sportit dhe Rinisë;
 - dh) Ministrin e Kulturës;
 - d) Ministrin e Mjedisit dhe Turizmit;
 - ë) Ministrin e Shtetit për Diasporën;
 - e) Guvernatorin e Bankës së Shqipërisë;
 - f) Kryetarin e Akademisë së Shkencave;
 - gj) Drejtorin e INSTAT-it.



SAMITI II DIASPORËS

3. Fusha e veprimtarisë së Komitetit përfshin:

- a) përgatitjen e linjave orientuese për hartimin e politikave të reja aktive dhe përcaktimin e prioriteteve strategjike në fushën e Diasporës;
 - b) propozimin e mekanizmave ligjorë dhe institucionalë për çështje që lidhen me përmirësimin e pozitës së anëtarëve të Diasporës dhe mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të tyre në vendet ku jetojnë;
 - c) nxitjen dhe zhvillimin e dialogut për zbatimin e strategjisë, politikave dhe legjislacionit në fushën e zhvillimit të komuniteteve të Diasporës;
 - ç) koordinimin dhe zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Diasporën;
 - d) mbështetjen dhe monitorimin e veprimtarisë së Agjencisë Kombëtare për Diasporën.
4. Komiteti mblidhet jo më pak se një herë në tre muaj dhe sa herë është e nevojshme, me kërkesë të Kryeministrit.
 5. Në mbledhjet e Komitetit mund të ftohen të marrin pjesë dhe përfaqësues të grupeve parlamentare, të organeve të qeverisjes qendrore e vendore apo të institucioneve të tjera, pjesëmarrja e të cilëve çmohet e vlefshme për përmbushjen e misionit.
 6. Veprimtaria e Komitetit mbështetet nga sekretariati teknik. Përbërja dhe detyrat e sekretariatit teknik përcaktohen me urdhër të Kryeministrit.
 7. Urdhri nr.115, datë 11.5.2006, i Kryeministrit, “Për ngritjen dhe funksionimin e Komitetit Ndërminstor të Migracionit”, shfuqizohet.
 8. Ngarkohen anëtarët e Komitetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA



SAMITI I DIASPORËS

REPUBLIKA E SHQIPËRISË KRYEMINISTRI

URDHËR

Nr.231, datë 7.12.2017

“PËR PËRBËRJEN DHE DETYRAT E SEKRETARIATIT TEKNIK TË KOMITETIT SHTETËROR PËR DIASPORËN”

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, dhe të pikës 6 të vendimit nr. 690, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin dhe funksionimin e Komitetit Shtetëror për Diasporën”,

URDHËROJ:

1. Sekretariati Teknik i Komitetit Shtetëror për Diasporën të kryesohet nga përfaqësuesi i ministrit të Shtetit për Diasporën dhe në përbërje të ketë anëtarë, përfaqësues nga:
 - Ministri i Shtetit për Diasporën;
 - Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme;
 - Ministria e Brendshme;
 - Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
 - Ministria e Drejtësisë;
 - Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë;
 - Ministria e Kulturës;
2. Detyrat kryesore të Sekretariatit Teknik të Komitetit Shtetëror për Diasporën janë, si më poshtë vijon:
 - Të përgatitë takimet e Komitetit;
 - Të raportojë periodikisht pranë Komitetit për realizimin e detyrave të përcaktuara në mbledhjet e mëparshme të tij;
 - Të bashkërendojë punën ndërmjet institucioneve të përfshira për zbatimin dhe monitorimin e detyrave të lëna nga Komiteti;
 - Të mbajë procesverbalet dhe të hartojë vendimet e marra nga Komiteti;
 - Të kryejë detyra të tjera të përcaktuara nga kryetari i Komitetit.
3. Sekretariati teknik të mblidhet rregullisht, me njoftimin e kryetarit.
4. Ngarkohen titullarët e institucioneve të përmendura në pikën 1, të këtij urdhri, që brenda 10 (dhjetë) ditësh nga data e hyrjes në fuqi të tij, t'i dërgojnë ministrit të Shtetit për Diasporën emrat e përfaqësuesve të tyre në sekretariat.



SAMITI II DIASPORËS

5. Ngarkohen anëtarët e Sekretariatit Teknik të Komitetit Shtetëror për Diasporën për ndjekjen e zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E M I N I S T R I

E D I R A M A



SAMITI II DIASPORËS

2.3 *Pas diskutimit në Komitetin Shtetëror të Diasporës për organizimin e Samitit të Dytë të Diasporës doli Urdhri i Kryeministrit Nr. 96, datë 16.07.2018:*

"PËR NGRITJEN E GRUPIT TË PUNËS PËR ORGANIZIMIN E SAMITIT TË DIASPORËS"



SAMITI II DIASPORËS

REPUBLIKA E SHQIPËRISË KRYEMINISTRI

URDHËR
Nr.96, datë 16.7.2018

“PËR NGRITJEN E GRUPIT TË PUNËS PËR ORGANIZIMIN E SAMITIT TË DIASPORËS”

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 12, të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, dhe të Vendimit nr.494 datë 13.09.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për Krijimin e komisionit shtetëror për organizimin e veprimtarive në kudër të “Vitet Mbarëkombëtar të Gjergj Kastriotit-Skënderbeut”, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Diasporën,

URDHËROJ:

1. Ngritjen e Grupit të Punës, për Organizimin e Samitit të II të Diasporës, që do të mbahet në Tiranë, në muajin nëntor 2018.
2. Grupi ndërinstitucional i punës kryesohet nga Zëvendëskryeministri dhe në përbërje të ketë anëtarë:
 - Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme;
 - Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë
 - Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë;
 - Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë;
 - Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës;
 - Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
 - Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit;
 - Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Brendshme;
 - Drejtorin e kabinetit të Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes;
 - Drejtorin e kabinetit të Ministrit të Shtetit për Diasporën;
 - Drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare;
 - Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit;
 - Drejtorin e Shërbimit Informativ të Shtetit;
 - Komandantin e Gardës së Republikës.



SAMITI II DIASPORËS

3. Me ftesë të kryetarit të grupit ndërinstitucional të punës mund të marrin pjesë në takime edhe ekspertë të tjerë nga brenda apo jashtë vendit, sipas nevojave që lidhen me fushën e veprimit të këtij urdhri.
4. Detyrat kryesore të grupit ndërinstitucional të punës të jenë hartimi i programeve, organizimi, drejtimi, bashkërendimi i punës, realizimi i veprimtarive, si edhe hartimi i projektakteve të nevojshme për organizimin e veprimtarisë dhe të efekteve financiare.
5. Projektaktet ti përcillen Komisionit Shtetëror për organizimin e veprimtarive në kuadër të “Vitet Mbarëkombëtar të Gjergj Kastriotit-Skënderbeut”, për ti propozuar në Këshillin e Ministrave.
6. Ngarkohen përfaqësuesit e ministrive dhe të institucioneve të përmendura në pikën 2 për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E M I N I S T R I

ED I R A M A



SAMITI II DIASPORËS

2.4 Me propozimin e Grupit të Punës për organizimin e Samitit të II-të të Diasporës u përcaktua niveli i shpenzimeve dhe institucioni i cili do të kryente ato. Mbi bazën e kësaj të fundit janë miratuar VKM Nr. 11, datë 09.01.2019 dhe VKM Nr. 194, datë 05.04.2019:

- **"PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2019 PËR DREJTORINË E SHËRBIMEVE QEVERTARE"**
- **"PËR KTHIM FONDI NË BUXHETIN E SHETIT"**



SAMITI II DIASPORËS

REPUBLIKA E SHQIPËRISË KËSHILLI I MINISTRAVE

VENDIM

Nr. 11, datë 9.1.2019

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2019 PËR DREJTORINË E SHËRBIMEVE QEVERTARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën,

VENDOSI:

1. Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare, në buxhetin e vitit 2019, në zërin “Shërbime qeveritare”, i shtohet fondi prej 66 972 800 (gjashtëdhjetë e gjashtë milionë e nëntëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e tetëqind) lekësh, brenda datës 31 janar 2019, për organizimin e Samitit të Dytë të Diasporës, që do të zhvillohet në datat 28 shkurt - 2 mars 2019 në Tiranë dhe Lezhë.
2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2019.
3. Ministria e Kulturës, brenda fushës së përgjegjësisë së vet, të bashkërendojë me Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare për organizimin e aktiviteteve social-kulturore dhe vendosjen në përdorim të monumenteve të kulturës, sipas rastit.
4. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Kulturës dhe Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA



SAMITI II DIASPORËS

RAPORTI FINANCIAR I SAMITIT TE DYTE TE DIASPORES

Nr	Përshkrimi	Vlera në Lekë (pa TVSH)	Vlera në Lekë (me TVSH)
1	Qera Expocity (1 ditë aktivitet dhe 9 ditë përgatitore)		10.875.000
2	Skenografi	14.811.500	17.773.800
	Paketa e Aktiviteteve + Materiale kancelarike 3 (800 persona)		15.000.000
4	Mbrëmje Gala	10.000.000	12.000.000
5	Regji për eventet	1.000.000	1.200.000
6	Pritja (teknike) Pallati i Brigadave	800.000	960.000
7	Koktejl Pallati i Brigadave (800 persona)		1.400.000
8	Brandim i bulevardit deri tek Zogu i Zi	1.800.000	2.160.000,0
9	Çmimet Shqiponja e Artë (15 çmime)		1.500.000
10	Transport ExpoCity (800 persona)		1.000.000
11	Transport në Lezhë (800 persona)		2.000.000
12	Aktiviteti në Lezhë	920000	1104000
	TOTALI		66.972.800



SAMITI II DIASPORËS

REPUBLIKA E SHQIPËRISË KËSHILLI I MINISTRAVE

VENDIM Nr.194, datë 5.4.2019

“PËR KTHIM FONDI NË BUXHETIN E SHETIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 45, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr.99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, të ndryshuar, me propozim të ministrit të Shtetit për Diasporën

VENDOSI:

Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare, të kthejë në fondin rezervë të buxhetit të shtetit shumën prej 14 561 598 (katërmëdhjetë milionë e pesëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e tetë) lekësh, fond i papërdorur nga fondi shtesë, i akorduar me vendimin nr.11, datë 9.1.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2019 për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare”, me qëllim organizimin e Samitit të Dytë të Diasporës.

1. Ky fond kalon nga zëri “Shërbime qeveritare” i Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare, në fondin rezervë të buxhetit të shtetit, brenda muajit prill 2019.
2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA



SAMITI II DIASPORËS

2.5 Për programimin dhe mënyrën e shpenzimit të fondeve për Samitin e II-të të Diasporës, Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare do të raportojë me shkrim në Komitetin Shtetëror për Diasporën.



SAMITI II DIASPORËS

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA KOMBËTARE E DIASPORËS

Nr. 16 Prot.

Tiranë, më 16.01.2019

Lënda: Relacion dhe kërkesë për programin e Samitit të Dytë të Diasporës

ZNJ. DHURATA SHAMIA DREJTORIA E SHËRBIMEVE QEVERTARE

Në takimin e dytë të Komitetit Shtetëror për Diasporën, organizuar më datë 23.10.2018, me propozim të Kryeministrit u vendos që organizimi i Samitit të Dytë të Diasporës nga muaji nëntor të shtyhet për tu realizuar në datat 28 shkurt - 2 mars 2019. Takimi kryesor do të zhvillohet tek qendra “Expo City” në Tiranë dhe në datë 2 Mars 2019 aktiviteti do të kryhet në qytetin e Lezhës.

Me urdhrin e Kryeministrit Nr.96, datë 16.7.2018 “Për ngritjen e grupit të punës për organizimin e Samitit të Diasporës” janë bërë propozimet për përmbushjen e detyrimeve financiare për këtë aktivitet të rëndësishëm kombëtar.

Bazuar në propozimet e grupit të punës të urdhrit të Kryeministrit Nr.96, datë 16.7.2018, Këshilli i Ministrave, vendosi nëpërmjet VKM Nr. 11 të dt. 9.01. 2019 “ Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2019 për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare”. Fondi prej 66972800 (gjashtëdhjetë e gjashtë milionë e nëntëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e tetëqind)lekë ashtu siç parashikohet në pikën 1 të tij është i përcaktuar “Për organizimin e Samitit të Dytë të Diasporës”.

Në zbatim të VKM Nr. 11 të dt.9.01.2019 për organizimin e Samitit të Dytë të Diasporës, lutem paraqitjen e programit të realizimit të punës së institucionit tuaj brenda datës 20 Janar 2019 për tu diskutuar në mbledhjen e radhës së Komitetit Shtetëror të Diasporës.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**DREJTORI EKZEKUTIV
DRITAN DELIJA**



SAMITI II DIASPORËS

III. FTESA ELEKTRONIKE



SAMITI I DIASPORËS
II

E GJITHË VËMENDJA PËR DIASPORËN!

Me **28 shkurt**, 1 dhe **2 mars 2019**, në përvjetorin e **575-të të Lidhjes së Lezhës**, Diaspora shqiptare do të mbledhet në samitin e saj të dytë, në **Tiranë**.
Së bashku për të farkëtuar ardhmëri me vëmendjen tek bashkëkombasit tanë!

#bashkuarpershpjperine #jeqipernien #vunjks #egjithvemendjapere



SAMITI I DIASPORËS
II

Fjala "atdhe" po rishkruhet. Ajo po lidhet me njerëzit.
Shqiptarët, si pak të tjerë, po ushtrojnë oilësinë e të qenit **një komb global**.

Samiti është një ftesë nga **"shtëpia e vogël"** e vendlindjes për ta kthyer botën në një shtëpi të madhe ku familja e shqiptarëve ka vendin e vet.

Gjërat e mëdha fillojnë nga të voglat.
MIRË SE ERDHE NË SHTËPI!

samitdiaspora.gov.al



SAMITI II DIASPORËS

IV. LETRA E KRYEMINISTRIT

REPUBLIKA E SHQIPËRISË KRYEMINISTRIT

Tiranë, më 18 janar 2019

Kjo është një letër për Ju, sikundër është edhe mirëfilli një ftesë.

Në kuadrin ogurmire të 575 vjetorit të Kuvendit të Lezhës, do të mbahet Samiti II i Diasporës shqiptare. Ky Kuvend zanafillën e pati në domosdoshmërinë e dialogut dhe përafrimit mes të barabartëve - inter pares - për t'u kthyer më pas, e për shekuj me radhë, në forcën e shembullit që mbujti identitetin tonë të përveçëm kombëtar në historinë e Evropës. Samiti është një ngjarje e pashoq. Ai është dëshmi e refuzimit të mbylljes në vetvete dhe e vullnetit për të bashkuar forcat kundruall sfidave të shekullit dhe epokës sonë. Samiti është udhërrëfyese i cili, pavarësisht larmisë së bindjeve vetjake dhe vendndodhjes së gjithsecilit, na jep dorë që, si shqiptarë, t'i qasemi sa më kthjellët sfidave të botës në të cilën jetojmë, trysnisë së teknologjive të informacionit dhe komunikimit, si edhe mënyrave të duhura dhe risiprurëse të organizmit mes nesh, në përputhje me kohën.

E ardhmja e kombit nuk farkëtohet sipas modeleve të parapërgatitura apo në bazë recetash çudibërëse. Çka sot për sot mund të tundojë lehtësisht, tjetërsimi i së vërtetës, keqpërdorimi i historisë, vetëmashtrimi për arsye ngushëllimi apo rehatie, nesër do të na e bëjë bashkëjetesën të vështirë.

Analiza lidhur me dukuritë migratore duhet të na bëjë edhe më të ndjeshëm dhe të qartë duke kuptuar njëherazi se proceset integruese, ai evropian në veçanti, janë sfida madhore për vetë mënyrën tonë të jetesës.

Udhëtimi i Odisesë drejt Itakës është një imazh shprehës se si kombi, një bashkësi gjithmonë në rrugëtim, është po ashtu një nocion dhe një koncept në shndërrim të vazhdueshëm. Me këto premisa edhe Samiti II i Diasporës shqiptare do të ketë doemos një fizionomi të re, ndryshe nga i pari. Ambicia është që ai të kthehet në forumin ku do të parashtrohen politikat e reja shtetërore në marrëdhënie me diasporën, nëpërmjet një metode bashkëpunimi që ndërlihd qytetarin dhe bashkëkombësin jashtë atdheut, me fatin e vendlindjes, vend origjinës dhe kombit.

Ju ftoj bash për këtë, të bëheni pjesë e gjallë dhe aktive e një ngjarje që të ardhmen e dëshiruar e rrok si një përpjekje angazhuese afatgjatë dhe që sot, prej jush, falë jush, bashkë me ju, zë fill. Në pritje për t'u takuar,

**I Juaji,
Edi RAMA**



SAMITI II DIASPORËS

V. PROGRAMI I SAMITIT

AGENDA E SAMITIT TË DYTË TË DIASPORËS SHQIPTARE

28 SHKURT - 2 MARS 2019

28 SHKURT 2019

- 14.00 Regjistrimi i pjesëmarrësve në Samit (Vendi: Pallati i Kongreseve)
- 19.00 Mirëseardhje në Tiranë - Ceremonia e mirëpritjes së pjesëmarrësve në Samit (Vendi: Pallati i Brigadave)
- 20:30 Mbrëmje e lirë

1 MARS 2019

- 09.00 Nisja drejt vendit ku do të mbahet Samiti (Drejt Expo City)
- 09.30 Mbërritja në Shtëpinë e Diasporës (Vendi: Expocity)
- 10.00 Sesion Kuvendues Plenar i Diasporës Shqiptare me Pjesëmarrjen e Autoriteteve Zyrtare (Vendi: Expocity)
- 11.15 Pushim kafeje (Vendi: Expocity)
- 11.30 Panele diskutimi paralele



SAMITI II DIASPORËS

Paneli I: “Vota si e drejtë! - Politika e re shtetërore për Diasporën” (Diaspora dhe të drejtat e saj në vendlindje)

Diskutime mbi mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve shqiptare të Diasporës. Garantimi i të drejtave politike dhe në veçanti i të drejtës së votës së shtetasve shqiptarë jashtë atdheut, pjesëmarrja në votime në shtetin e tyre të origjinës. Miratimi i ligjit që parashikon marrjen e masave koordinuese për realizimin e të drejtës së votës së Diasporës me nënshtetësi shqiptare në zgjedhje. Rëndësia e materialit mbi votimin e shtetasve shqiptarë jashtë vendit. Mbrojtja dhe gëzimi “de facto” i të drejtave kushtetuese nga migrantët, masat shtesë që mund të marrin organet shtetërore. Diskutim mbi të drejtat e shtetasve shqiptarë jashtë vendit, për pjesëmarrje më aktive në zhvillimet e vendit amë.

Paneli II: “Zhvillimi ekonomik i qëndrueshëm - “Vendlindja dhe Diaspora” (Ekonomia, Remitancat, Sipërmarrja)

Diskutime për institucionet dhe zbatimin e politikave që synojnë nxitjen e investimeve dhe kanalizimin e dërgesave të emigrantëve me institucionet financiare në vendet pritëse. Dialog për remitancat dhe politikatat nxitëse bankare për Diasporën shqiptare. Kalimi dërgesave të migrantëve nga rrugët informale të transferimit në ato formale. Lehtësimi e tërheqjes së investimeve nga Diaspora. Rrjetet e biznesit në Diasporë dhe i shkëmbimit të informacionit funksional, shfrytëzimin e potencialit ekonomik që Diaspora mbart në vetvete, në shërbim të zhvillimit ekonomik dhe social të vendit.

Paneli III: “Identiteti shqiptar - E ardhmja fillon nga Diaspora!” (Arsimi, Kultura, Arti dhe Filantropia si cilësi komunitare)

Diskutimi i ndryshimeve ligjore të kryera dhe marrëveshjeve midis Shqipërisë dhe Kosovës në këtë fushë. Kultura dhe programet e reja për ruajtjen e identitetit shqiptar. Kurrikula e re e cila zyrtarizon mësimin shqip në Diasporë. Mësimi i gjuhës shqipe është çështje me përparësi për Diasporën shqiptare, dhe për vazhdimësinë e identitetit gjuhësor. Krijimi i Qendrës së Botimeve për Diasporën dhe tekstet që do të shërbejnë për mësimin e gjuhës shqipe. Projekti e-book nëpërmjet të cilit mundësohet shkarkimi on-line i teksteve shkollore të vendosura në programin arsimor për Diasporën.



SAMITI II DIASPORËS

Krijimi i qendrave kulturore, të cilat kanë si mision ruajtjen, kultivimin e identitetit kombëtar, gjuhësor, kulturor e arsimor të Diasporës dhe forcimin e lidhjeve të saj me institucionet e Republikës së Shqipërisë. Modelet e filantropisë për këtë fushë dhe mundësitë e bashkëpunimit.

Paneli IV: “Ftesë nga shtëpia juaj” (Turizëm, Agroturizëm)

Diskutim mbi mundësitë turistike të zonës rurale. Vendorsja e fokusit në investimet që kanë si synim transformimin rrënjësor të zonave rurale duke i kthyer në potencial turistik. Diskutimi i projektit “100 fshatrat” si pjesë e Programit të Integruar për Zhvillimin Rural. Diskutim mbi eksperiencat e vendeve të Evropës, të përparuara në këtë drejtim, me qëllim realizimin e objektivave. Ofrimi i mundësive ekonomike në hapësirën rurale dhe tërheqja e turistëve elitarë. Ndryshimet ligjore në këtë fushë me interes edhe për kultivimin e marrëdhënieve midis Diasporës dhe vendlindjes.



SAMITI II DIASPORËS

- 13:30 Sesion Përmbyllës: Konkluzionet e Diskutimeve dhe Dokumentit Përfundimtar të Samitit Nën kujdesin e ekspertizës së IOM (Vendi: Expo City)
- 15.00 Nisja drejt vendeve të drekës (Vendi: Expo City)
- 18.30 Mbërritja në Mbrëmjen Gala (Vendi: Pallati i Kongreseve)
- 19.00 Mbrëmja Gala e Samitit II të Diasporës Shqiptare Dorëzimi i trofeve “Shqiponja e Artë e Diasporës” Dorëzimi i titullit “Ambasadori i Kombit”
- 20.30 Darkë e lirë

2 MARS 2019

- 09.30 Nisja drejt Lezhës (Nisja nga hotelet e prenotuara)
- 12.00 Ceremonia e 575 vjetorit të Besëlidhjes së Lezhës (Vendi: Lezhë)
- 13.00 Drekë buffet në nder të pjesëmarrësve në Samit nga Kryetari i Bashkisë Lezhë (Vendi: Mjediset e Bashkisë Lezhë)
- 15.30 Nisja drejt Tiranës
- 17.30 Mbërritja në Tiranë
- 18:00 Darkë ë lirë



SAMITI II DIASPORËS

VI. REZOLUTA E KUVENDIT

MIRATOHET

K R Y E T A R I

Gramoz RUÇI

REZOLUTË

PËR REFORMËN E POLITIKËS SHTETËRORE PËR

DIASPORËN

Kuvendi i Shqipërisë:

- Duke vlerësuar hapat e hedhur në ndërtimin e strukturave të politikës shtetërore për Diasporën;
- Duke vlerësuar reformën legislative kushtuar komuniteteve shqiptare jashtë vendit dhe konkretisht miratimin brenda një periudhe të shkurtër të ligjit nr. 16/2018 “Për Diasporën”, ligjit nr. 115/2017 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës” dhe ligjit nr. 32/2018 “Për Fondin e Zhvillimit të Diasporës”;
- Duke konsideruar veprimtarinë shtetërore në këtë fushë si të një rëndësie të veçantë, e cila lidh përgjegjësitë e shtetit shqiptar me statusin ligjor të shtetasve dhe bashkëkombësve tanë jashtë vendit;
- Duke vlerësuar bashkëpunimin me shtetin e Kosovës dhe vendeve të tjera fqinje, në këtë drejtim të rëndësishëm dhe strategjik për të ardhmen, si pjesë e procesit të integrimit evropian të rajonit;
- Duke i konsideruar të rëndësishme propozimet e Nënkomisionit për Diasporën në lidhje me: Miratimin e Strategjisë Kombëtare për Diasporën 2018-2024 nga Këshilli i Ministrave si një dokument kyç për veprimin dhe aplikimin e politikave të reja të institucioneve shtetërore në këtë fushë të veprimtarisë shtetërore.

Nisjen sa më shpejt të funksionimit të institucioneve të krijuara nga legjislacioni i ri i miratuar për këtë qëllim.



SAMITI II DIASPORËS

Bashkëpunimin institucional, në mënyrë të veçantë, me shtetin e Kosovës për të përcaktuar një politikë të qëndrueshme dhe afatgjatë në funksion të interesave të komuniteteve shqiptare aty ku ata jetojnë, në vendet pritëse.

Punën paraprake të Komisionit të Reformës Zgjedhore, në programin e diskutimit të së cilit një nga çështjet për t'u diskutuar dhe vendosur është dhënia e së drejtës së votës shtetasve shqiptarë, të cilët banojnë jashtë vendit.

Vendimin e Këshillit të Ministrave që me rastin e vitit të "Gjergj Kastrioti Skënderbeut" të organizohet në Tiranë, aktiviteti i Samitit të Dytë të Diasporës Shqiptare.

Duke vërejtur dhe vlerësuar se:

- Në vitin 2017 - 2018, në Kryesinë e Kuvendit janë organizuar disa aktivitete në funksion të interesave të Diasporës dhe migracionit. Këto takime publike kanë qenë një rast për ta bërë të ndjeshme edhe më shumë për nivele të ndryshme të politikës dhe administratës garantimin e të drejtave kushtetuese të Diasporës dhe migracionit.
- Krijimi i një kanali televiziv "TVSH 3" nga Radio Televizioni Publik i Shqipërisë në zbatim të ligjit "Për Diasporën" është një hap i rëndësishëm për forcimin e komunikimit me bashkëkombësit jashtë vendit.
- Fillimi i punës nga Muzeu Kombëtar, në bazë të ligjit të ri "Për Diasporën", për hapësirën brenda tij kushtuar historikut të Diasporës shqiptare, është një detyrim ligjor dhe moral ndaj shtresës së shoqërisë shqiptare që e ka ndihmuar vendin nga distanca e mërgimit. Shembujt e kësaj ndihme vlejné edhe sot në kushtet e një shoqërie globale, ku ruajtja e identitetit është detyrë dhe sfidë shtetërore.
- Miratimi nga ministritë përgjegjëse të arsimit të Shqipërisë dhe të Kosovës i "curriculave" të arsimit në Diasporë është një hap i rëndësishëm për ruajtjen e identitetit kulturor e arsimor shqiptar në Diasporë. Kjo punë e nisur duhet të përfundojë me realizimin e librave mësimorë të nevojshëm për brezin e ri të shqiptarëve të mërguar.
- Organizimet kulturore në Diasporë kanë filluar të kenë një rol të dorës së parë në ruajtjen e identitetit jashtë vendit. Ngritja e qendrave të kulturës në Diasporë, sipas legjislacionit të ri dhe në bashkëpunim me shtetin e Kosovës, në funksion të marrëveshjeve bilaterale midis dy shteteve, do të ndihmojnë në krijimin e një programi kulturor të përbashkët për bashkëkombësit dhe brezat e rinj në Diasporë.



SAMITI II DIASPORËS

- Ministria për Evropën dhe Politikën e Jashtme ka ndërmarrë veprime të rëndësishme në fushën e shërbimeve konsullore për shtetasit shqiptarë që jetojnë jashtë vendit. Shërbimet "on-line" kanë lehtësuar dhe shkurtuar procedurat burokratike në shërbimet konsullore. Kjo ministri ka firmosur dhe po negocion marrëveshje të rëndësishme për cilësinë e jetës së shtetasve shqiptarë jashtë vendit, siç janë ato në fushën e sigurimeve.
- Krijimi i Qendrës së Botimeve për Diasporën, në zbatim të legjislacionit të ri për Diasporën është hap i rëndësishëm në ruajtjen e identitetit dhe arsimimit për shqiptarët e rinj larg vendlindjes. Kjo qendër do të shërbejë si një cilësi e re në fushën e publikimeve dhe shpërndarjes së librit për Diasporën.
- Për shtetasit që janë larguar nga vendi ekziston një numër i ulët botimesh "on-line" në gjuhën shqipe. Në këtë drejtim kërkohet një bashkëpunim institucional të ministrive përgjegjëse të arsimit, kulturës dhe Diasporës për të gjetur zgjidhjet dhe krijuar rezultatet.
- Marrëdhënia e Shqipërisë me Diasporën po ndjen nevojën e bashkëpunimit me inteligjencën dhe fuqinë punëtore të kualifikuar jashtë vendit.
- Përfshirja e Diasporës në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të Shqipërisë është një sfidë administrative. Fillimi i punës për krijimin e Dhomës së Biznesit për Diasporën është një hap i rëndësishëm në drejtimin e duhur.

Kërkon:

- Nënkomisioni për Diasporën dhe Migracionin krijuar me vendimin nr. 98/2017 të Kuvendit të Shqipërisë si tregues i vëmendjes në rritje që Kuvendi, si institucioni më i lartë i vendit, i ka dedikuar kësaj çështjeje, të ketë rol aktiv në ndjekjen e zbatimit të kuadrit ligjor për Diasporën dhe të jetë një interlokutor, në emër të Kuvendit, për verifikimin dhe informimin me ecurinë e reformës në fushat të cilat ai mbulon.
- Angazhimin në vazhdimësi nga institucionet dhe agjencitë përgjegjëse të administratës në vlerësimin e masave të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës 2018 - 2024.
- Zgjidhjen e së drejtës së votës për shtetasit shqiptarë jashtë vendit me mekanizma ligjorë nga Komisioni i Reformës Zgjedhore, duke u bazuar në modelet e njohura perëndimore, në bashkëpunim me OSBE-ODIHR-in.
- Bërjen funksionale në bazë të legjislacionit të miratuar, të organizimit institucional dhe strukturave shtetërore për Diasporën brenda vitit 2018.
- Koordinimin me institucionet përgjegjëse në fushën e Diasporës të shtetit të Kosovës për hedhjen e hapave të përbashkët, në një marrëdhënie ku është i rëndësishëm edhe bashkëpunimi me shtetet e tjera fqinje dhe rajon.



SAMITI II DIASPORËS

- Krijimi i një programi të veçantë nga ministrinë përgjegjëse për arsimin, kulturën dhe diasporën për botimet "on-line" në fushën e arsimit dhe librit shqip, për të cilin komisionet përgjegjëse në Kuvendin e Shqipërisë të kërkojnë informacion.
- Nxitjen e organeve të vetëqeverisjes vendore për të mundësuar aksesin e Diasporës, me qëllim shkurtimin e "distancave" administrative me shtresën popullore që nuk jeton brenda vendit.
- Paraqitjen dhe/ose ndërmarrjen e nismave të nevojshme nga organet kompetente për rishikimin e ligjit "Për shtetësinë" dhe kuadrit ligjor përkatës për t'iu përgjigjur shqetësimeve të shtetasve shqiptarë jashtë vendit dhe fenomenit të "pashtetësisë", të ngritur nga struktura përgjegjëse e OKB-së për këtë çështje, zyra e UNCHR-së në Tiranë.

Kuvendi i Shqipërisë vlerëson si të nevojshme diskutimin dhe vlerësimin periodik të çështjeve që kanë të bëjnë me Diasporën dhe interesat e shtetasve shqiptarë jashtë vendit. Ai konsideron se në kushtet e reja sociale dhe procesin e integritit në Bashkimin Evropian, dallimet e shtetasve, të cilët jetojnë "jashtë" dhe "brenda" vendit, janë ngushtuar. Ato kërkojnë përgjigje ligjore dhe administrative të duhura.

Diaspora është pasuria kombëtare e Shqipërisë. Kuvendi i Shqipërisë është i përkushtuar që kjo të kthehet në një realitet të prekshëm nga qytetarët që kanë votuar apo që do të votojnë nesër për të ardhmen e përbashkët.

Miraturar në datën 23.07.2018



SAMITI I DIASPORËS

VII. SHPËRNDARJA E FTESAVE ZYRTARE

NUMRI I TË FTUARËVE NË SAMITIN E DYTË TË DIASPORËS

•Gjermani	50 pjesëmarrës
•Francë	20 pjesëmarrës
•Itali	70 pjesëmarrës
•Turqia	40 pjesëmarrës
•SHBA	70 pjesëmarrës
•Belgjikë	40 pjesëmarrës
•Holandë	15 pjesëmarrës
•Mbretëria e Bashkuar	60 pjesëmarrës
•Danimarka	30 pjesëmarrës
•Greqia	100 pjesëmarrës
•Spanja	10 pjesëmarrës
•Austria	35 pjesëmarrës
•Finlanda	10 pjesëmarrës
•Suedia	25 pjesëmarrës
•Polonia	10 pjesëmarrës
•Republika Çeke	10 pjesëmarrës
•Bullgaria	10 pjesëmarrës
•Rumania	20 pjesëmarrës
•Kroacia	20 pjesëmarrës
•Kanada	50 pjesëmarrës
•Australia	5 pjesëmarrës
•Ukraina	10 pjesëmarrës
•Zvicra	30 pjesëmarrës
•Argjentina	5 pjesëmarrës
•Liban	5 pjesëmarrës



SAMITI II DIASPORËS

VIII. APLIKIMI ON-LINE PËR PJESËMARRJEN NË SAMIT

Kriteret e regjistrimit për pjesëmarrje

Samiti i Dytë i Diasporës është një aktivitet i hapur për pjesëmarrës nga e gjithë hapësira shqiptare. Samiti do të ketë një numër të caktuar të ftuarish nominal me ftesë zyrtare. Në këtë aktivitet mbarëkombëtar do të ftohen personalitete të njohura të Diasporës, kryetarët e organizatave dhe shoqatave që veprojnë në Diasporë dhe persona, të cilët kanë një histori sukseesi në vendet ku jetojnë.

Cilido që dëshiron të marrë pjesë në këtë Samit mund të regjistrohet "on-line". Është e rëndësishme që, pas regjistrimit, të keni edhe konfirmimin e pjesëmarrjes në Samit, për efekte organizative të aktivitetit.

Ata që dëshirojnë të marrin pjesë në Samitin e Dytë të Diasporës, duhet të kenë marrë pjesë në mënyrë aktive në mbrojtjen e interesave të bashkësisë shqiptare, si edhe në zhvillimin e promovimin e identitetit, vlerave dhe traditës kombëtare në vendin ku jetojnë. Vlerësim të veçantë do të ketë për ata të cilët janë të angazhuar në jetën politike apo shoqërore të komunitetit, nëpërmjet organizatave, klubeve shqiptare dhe aktiviteteve të tyre, si kontribut për konsolidimin e lidhjeve në komunitet, por edhe për rritjen e influencës në dobi të interesave kombëtare dhe të forcimit të lidhjeve e bashkëpunimit me vendlindjen.

The image shows a screenshot of a web-based registration form for the 'SAMITI I DYTË I DIASPORËS'. The form is titled 'REGJISTRIMI NË SAMIT' and includes the following fields:

- Emri / Name *
- Adresa / Address *
- Numri i telefonit / Phone *
- Emri i emailit / Email *
- Mënyra e jetesës / Lifestyle *
- Profesioni / Profesioni *
- Numri i telefonit / Phone *

Below the form, there is a section for 'Mënyra e jetesës / Lifestyle' with radio button options:

- Bëni pjesë të organizatave dhe shoqatave shqiptare në vendin ku jetojnë.
- Bëni pjesë të organizatave dhe shoqatave shqiptare në vendin ku jetojnë dhe në vendin tuaj.
- Bëni pjesë të organizatave dhe shoqatave shqiptare në vendin tuaj dhe në vendin ku jetojnë.
- Bëni pjesë të organizatave dhe shoqatave shqiptare në vendin tuaj dhe në vendin ku jetojnë dhe në vendin tuaj.

The form is displayed on a website with a header and footer. The header includes the title 'Samiti i Diasporës Shqiptare' and navigation links: Home, Regjistrimi në samit, Samiti, Diaspora, Kontakt. The footer includes the website name 'Samiti i Diasporës Shqiptare', the address 'Rr. Dëshmorët e Kosovës, Nr. 10, Tiranë', and social media icons for Facebook and YouTube.



2019